Në gjithë hapësirën e atëhershme të Federatës së Jugosllavisë, pas fitores së antidogmatikëve në Brioni, u shfaq dhe sundonte një frymë liberale. Njerëzit nisën të flisnin më lirisht dhe u bë e vetëkuptueshme se mund të diskutohej me një frymë kritike për çdo gjë dhe e vetmja gjë nuk mund të bëhej objekt kritikash ishte karakteri socialist i rregullimit shtetëror (nënkuptohej si përjashtim dhe e ndalueshme, ose sanksionuese çdo ide për vendosjen e një rendi shtetëror shumëpartiak, pra gjithë pushteti në duart e partisë komuniste) dhe tërësia tokësore e Federatës së Jugosllavisë, ose luftë e pamëshirshme çdo ideje të vetëvendosjes ose shkëputjes nga shteti i quajtur Jugosllavi, sinjale këto të drejtuara shqiptarëve dhe kroatëve). Autorit të këtij artikulli i kujtohet një diskutim publik, i drejtuar nga një funksionar republikan i Serbisë, në pranverën e hershme të vitit 1968, në ambientet e Fakultetit Filologjik të Beogradit. Temë e preferueshme atëherë e gjithmonë më pas, ishin "marrëdhëniet ndërnacionale" në Jugosllavi. Kishte këtu mjaft studentë shqiptarë, ndër ta, nga Gostivari Qamil Kita, inxh. i agronomisë, me punë tashti gazetar i Radio Shkupit, Ejup Limani, mjek, Bardhyl Shatku, i kthyer së shpejti në Gostivar nga një jetë e gjatë në ekzil në Amerikë; studentë të atëhershëm shqiptarë në Universitetin e Novi Sadit të ardhur enkast për këtë diskutim publik në Beograd, Nazif Selimi, gazetar, drejtor i Dikasterit të Punës në Gostivar, tashti bashkëpunëtor i këtij Dikasteri, Ferit Fejzullahu, gazetar, redaktor në Radio Shkupi. Drejtuesi i diskutimit, funksionari serb, për habinë tonë të madhe përmendi edhe të drejtën e Kosovës për t'u shkëputur nga Jugosllavia. Pasi dëgjoji ca të përshpëritura nga auditori (sikur i tha vetes se rrëshqita shumë), e riformuloi këtë pohim si të drejtë e si çështje parimi, që LK (Lidhja e Komunistëve, ashtu quhej zyrtarisht partia komuniste e Jugosllavisë) "nuk e konsideron për temë tabu", por, vazhdoi ai përafërsisht se, të insistohej për diçka të tillë (shkëputjen e Kosovës) do të ishte një akt i papranueshëm kontrarevolucionar që do të cenonte parimet e themelimit të Jugosllavisë dhe vazhdoi me arsyetime të ngjashme për të përfunduar se Jugosllavia nuk do të lejonte kurrë që të shkëputej Kosova. E përmenda këtë rast si shembull për të pasqyruar atë frymën liberale që nisi të përhapej atëherë në ish-Jugosllavinë, por jo edhe kudo brenda kufijve të saj. Në trevat shqiptare hija e tmerreve të fundit të përjetuara pas Luftës së Dytë Botërore ishte akoma e rëndë. Fryma e plotë liberale ishte diçka e ëndërrueshme dhe UDB-ja famëkeqe punonte kundër shqiptarëve të ashtuquajturës Maqedoni sikur të mos ishte mbajtur Konferenca e Brionëve. Nuk kishte njerëz që do të mund të dilnin me ndonjë ide për të ndryshuar pozitën tonë të rëndë kombëtare dhe shoqërore, aq më pak këtë punë kishin vullnet e guxim ta çonin para ata pak politikanë shqipfolës, të lindur biologjikisht si shqiptarë. Kishte edhe përjashtime fare të vogla. Një pjesë të punës rreth konstatimit të padrejtësive dhe persekutimeve që iu bëheshin shqiptarëve në të ashtuquajturën Maqedoni dhe rreth përpjekjeve për të avancuar pozitën e tyre në trevat arbërore e bënin të tjerët. Duhet të sjellim ndër mend me mirënjohje të thellë angazhimin e të përjavshmes kroate VUS, gazetë kjo që ishte edhe zëdhënësja jonë atëhere. Ne shqiptarët jemi një popull me sedër të lartë kombëtare, por me kulturë të ulët politike dhe i harrojmë miqtë sa na bie puna të ndiemi pak më të lirë. Pohimin e ndërlihdh me punën e madhe që bënte në favor të çështjes shqiptare ahëre e përjavshmja e Zagrebit VUS, deri më kohën e mbylljes së saj, aty rreth vitit 1972. Afër mendsh që atdhetarëve kroatë iu duheshin aleatë në luftën e tyre për aspirata çlirimtare kombëtare, por aq më shumë na duheshin e na duhen neve shqiptarëve aleatë. Si digresion vetëm të them se nuk kam lexuar kundërshtime ndonjë artikull me përmbajtje mirënjohëse për gazetën kroate VUS. Në Kosovë diskutohej pak më lirshëm rreth

ndryshimeve kushtetuese dhe kjo kohë kishte protagonistët e saj shqiptarë të guximshëm. Sido që të jetë, idetë nuk mund të ngujohen a të burgosen. Sado që shqiptarët në të ashtuquajturën Maqedoni ndodheshin në rrethana shumë më të vështira se sa ata të Kosovës, një frymë e fare e lehtë liberalizmi politik përshkoi edhe trevat shqiptare të Jugosllavisë së atëhershme. SHQIPTARËT BËHEN TË ZËSHËMAhmet Kita, ekonomist i diplomuar, në fillim të vitit 1967 zgjidhet kryetari i Organizatës (Lidhjes, zyrtarisht) së Rinisë në komunën e Gostivarit. Një atdhetar i ri ahere, gjithë guxim e plot entuziazëm, i përkrahur nga Shasivar Hyseini, sot avokat në Gostivar, i ndjeri Imer Imeri¹², mjek dhe personi numër një i Partisë së Prosperitetit Demokratik në "Besëlidhjen" e Ohrit e të tjerë, marrin guxim dhe nisin diskutimet në mbledhjet e kësaj organizate rinore përkitazi me pozitën nënshtruese të shqiptarëve në komunën e Gostivarit.

DR. IMER IMERI



Po për këtë nismë vihet në dijeni edhe sekretari i Lidhjes Socialiste të Gostivarit, Sefer Selimi, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare. Detyrë e këtij të fundit, sipas Shasivar Hyseinit, avokat, kishte pas qenë që të siguronte shënime statistikore për strukturën nacionale të zënëve me punë në të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore në komunën e Gostivarit, duke ndriçuar aspekte të padrejtësisë së madhe ndaj shqiptarëve. Në Gostivar nis një rrymë e re me impulse të shquara kombëtare shqiptare në formë të diskutimeve në ambiente të ndryshme për të ndryshuar pozitën nënshtruese kombëtare të shqiptarëve. Diskutimet e guximshme nëpër forumet formale dhe konfrontimet e hapura me funksionarë sllavomaqedonasë, që nga niveli komunal deri në atë republikan, bëhen më të mprehta e më intensive. Tash më bëhen të njohura edhe botërisht qëndrimet e bllokut të politikanëve lokalë shqiptarë, Ahmet Kita me shokë në organizatën e rinisë, të mbështetur edhe nga Sefer Selimi e Destan Sylejmani në Lidhjen Socialiste. Qëndrimet e tyre mirëpritën nga popullata e politizuar shqiptare dhe interpretohen në ambiente familjare, në muhabete kafenesh, biseda miqësh e nëpër sheshe fshatrash.

12 Imer Imeri lindi më 29.04.1942, në fshatin Çegran-Gostivar. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme në Shkup në shkollën Normale dhe pastaj u punësua si mësues në fshatin Sërmnovë. Imeri njihet edhe si një nga organizatorët e ngritjes së flamurit shqiptar në Gostivar dhe rrethinë më 28 Nëntor 1968. Pas këtij manifestimi, së bashku me shokët e tij, u ndoq dhe u burgos. U dënua me 5 vjet burg. Pas daljes nga burgu detyrohet të punoj punë fizike për mbijetesë. Në vitin 1976 regjistrohet në fakultetin e mjekësisë në Prishtinë të cilin e mbaroi në vitin 1981. Pasi që nuk iu lejua që të punojë si mjek në vendlindje, detyrohet të punësohet si mjek në disa fshatra të Kosovës. Pas specializimit punësohet në Prishtinë në poliklinikën e studentëve. Gjatë viteve 1989-90 aktivisht merr pjesë në formimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Pas dëbimit masiv të shqiptarëve nga puna në Kosovë detyrohet të kthehet në vendlindje ku punon si mjek dhe angazhohet aktivisht në strukturat e Partisë për Prosperitet Demokratik. Në vitin 1993 ishte anëtar i qeveris së Maqedonisë si zëvendës ministër i shëndetësisë, ndërsa në vitin 2000 zgjidhet kryetar i PPD-së. Imeri Imeri, gjatë karrierës së tij politike dha një kontribut të madh për avancimin e çështjes së shqiptarëve në Maqedoni. Imeri një kohë të gjatë punoi si mjek, ndërsa në vitet e 90-ta ushtroi edhe disa funksione të larta shtetërore dhe partiake. Aktivitetin e tij patriotik dhe politik e kurorëzoi në vitin 2001, me marrvëshjen e Prizrenit, të nënshkruar Imer Imeri (PPD), Arben Xhaferi (PDSH) me Ali Ahmetin përfaqësuesi politik i UÇK-së. Gjithashtu ishte nënshkruar i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Ndërroi jetë më 29.06.2008, në moshën 66 vjeçare.

UDB-ja shqetësohet dhe druan se gjithë kjo atmosferë e ringjalljes së guximit kombëtar mund të kalojë në një lëvizje të përgjithshme për pozitë të barabartë të shqiptarëve me popullatën sllave. Qarqet e sigurimit shtetëror të ashtuquajturës Maqedoni nisin e gatuajnë plane për të ndërprerë këtë hov kombëtar ndër shqiptarët e trevës së Gostivarit. Ahmet Kita, ndërkohë, dërgohet në detyrimin ushtarak, ndërsa aktiviteti politik i shqiptarëve i nisur muaj më parë vazhdon e ngjallet edhe më shumë nga diskutimet nëpër forume të Sefer Selimit me përkrahës të tjerë shqiptarë. Sllavomaqedonasit shovinistë janë të shqetësuar.

ATENTATI POLITIK

Më janar të vitit 1968, disa metra para portës së shtëpisë së vet, në prani të vajzës 12-vjeçare, Sefer Selimi goditet për vdekje me disa plumba pas shpine (në shpatull e në kokë). UDB-ja nuk pret, "zbulon" dhe përhap lajmin se kush kishte pas qenë Sefer Selimi: "Agjent i Shqipërisë, në shtëpinë e të cilit na qenkësh gjetur radiostacioni ilegal". Kjo gjetje, "pa autor zyrtar", se kush paskësh qenë Sefer Selimi, duhej të kuptohej atëherë se përse e vramë Sefer Selimin (ne, UDB-ja; që e përhapi lajmin e zbulimit se kush ishte ai). Dorasi u mbajt dy- tre muaj në parburgim që të lirohej të mbrohej në liri me arsyetim se paskësh shtënë në vetëmbrojtje. Nuk vonoi shumë, një mbrëmje vjeshte likuidohet edhe ai (dorasi i Sefer Selimit) në rrethana gjysmëmisterioze. Skenari është i vetëkuptueshëm. Është për keqardhje të thuhet se sot e kësaj dite disa ish-komunistë shqipfolës, të reformuar në atdhetarë, pohojnë se nuk paskësh pasur argumente për të pohuar se kjo vrasje u bë për motive politike! Pse e vranë Sefer Selimin? Nga se ishte një nga aktualizuesit e diskutimeve nëpër forume politike për pozitën nënshtruese kombëtare e shoqërore-ekonomike të shqiptarëve; nga se ishte njëri nga nismëtarër kryesorë të diskutimeve me anën e të cilave kërkohesh që shqipja të ketë statusin e gjuhës zyrtare në të ashtuquajturën Maqedoni. Për aktualizimin dhe insistimin e publikimit të shkaqeve që detyruan qindra mijëra shqiptarë të shpërnguleshin në Turqi. Për insistimin që të ndriçohej e të gjykohej politikisht roli i veçantë i organeve të ndjekjes e i sigurimit shtetëror që me anë të represalieve e në forma të ndryshme krijoi gjendjen e shqetësimit dhe të pasigurisë ndër shqiptarët. Për ndriçimin statistikor të mospunësimit skandaloz të shqiptarëve në ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore e gjysmështetërore, të quajtura "shoqërore". Skenaristët e këtij atentati politik me siguri që llogaritnin se me një goditje kriminale do të arrinin efekte të shumta. Së pari, sipas tyre, kjo vrasje do të kuptohej si paralajmërim nga ana e bllokut të politikanëve lokalë shqiptarë se edhe ata do të mund të pësonin si Sefer Selimi, kurse në popullatën e gjerë shqiptare do të kuptohej si mesazh që të mos mirëpriteshin dhe të mos i mbështetnin idetë e bllokut të politikanëve lokalë shqiptarë. Vrasja e Sefer Selimit nuk arriti efektet e parapara në shkallë të dëshirueshme për regjisorët. Megjithatë, duhet të theksojmë se pati efekte negative ndër shqiptarët. Njerëzit nisën të bëhen më të heshtur e më të kujdesshëm. U shfaq psikoza e mosbesimit të ndërsjellë ndër shqiptarët. E mira e kësaj të keqeje ishte se u shtua neveria ndaj afijeve ose bashkëpunëtorëve të ditur të UDB-ës. Nisi një lloj taborizim apo polarizimi ndër fshatrat shqiptare ndërmjet atyre që grumbulloheshin rreth atyre të shtetit, (lojalistë e persona me prirje udhëbiste, që ishin fare të paktë) dhe shtëpive të shquara për atdhetari. Konfrontimet verbale dhe fizike ndërmjet popullatës shqiptare e sllave u bënë çështje e zakonshme në jetën e përditshme. Shqiptarët kërcënoheshin nga ana e sllavëve se "po të duan të kërkojnë të drejta, le të shkojnë në Shqipëri" dhe se duhet ta dinin, shqiptarët, siç iu "rekomandohej" se: "këtu nuk është Shqipëri, dhe as Kosovë". Këso "këshillash" iu

drejtoreshin shqiptarëve botërisht edhe nëpërmjet mediave shtetërore dhe përmes lojalistëve shqipfolës.

SHQIPTARËT NUK HESHTIN

Si kundërpërgjigje, atdhetarët shqiptarë shpalonin flamurin kombëtar nëpër godina botore, kuptohet ilegalisht, për të treguar shovinistëve sllavë se shërbehen me një gjeografi të gabuar. Jo vetëm kaq. Për të treguar e manifestuar sedrën kombëtare, një grup atdhetarësh defiloi nëpër Gostivar me flamurin kombëtar. Në këtë mënyrë njëherit iu tregohej armiqëve të shqiptarëve se kush janë të zotët e këtyre tokave. Pasiun represaliet dhe burgosjet në masë. Ky gjykim njihet në popull si "burgosjet për flamurin" më 1968. Protagonistë i ndjeri Jamin Nuredini, vite më parë prefekt i komunës së Gostivarit, me shokë nga Vërtoku i Gostivarit: Jusuf, Mustafa dhe Xhavit Muharremi e Refik Dauti, vëllezërit Naim e Zydi Bilalli dhe i ndjeri Imer Imeri, nga Çegrani i Gostivarit. Pasi kthehet nga detyrimi ushtarak, nga fundi i 68-ës, Ahmet Kita mbetet pa punë. Atij më parë i rrëmbehet në mënyrë të kundërligjshme funksioni i kryetarit të Organizatës së Rinisë së Gostivarit. Intrigat për ta burgosur dalin të pasuksesshme. Detyrohet të shpërngulet në Kosovë dhe tashti atje, më 2003, për këto merita atdhetarie lihet pa punë.

Të provokuar nga një element udb-istë sllav, në vjeshtë të vitit 1968 shqiptarët e Tetovës dalin në një demonstratë të madhe, ndërkohë që bashkëkombësit e tyre në Prishtinë kërkojnë të jenë të barabartë me popujt e tjerë të Federatës së Jugosllavisë-Kosova Republikë!

Tirana komuniste e Enverit është kundër kërkesave të shqiptarëve. Besa e tradhtisë vazhdon të kultivohet me sukses. Vitet kalojnë dhe diskutimet për rregullimin e ardhshëm të federatës, të njohura si diskutimet për amendamentet kushtetuese, bëhen gjithnjë e më konfrontuese e më konfliktuoze si në forumet politike ashtu edhe në mediat. Blloku antidogmatik e antihegjemontist ose antiunitarist angazhohet për një barazi më të madhe ndërmjet popujve të Federatës së Jugosllavisë. Më të zëshëm janë politikanët kroatë në krye me Tripalon dhe zonjën Kuçar, të cilët gëzojnë mbështetje të gjerë në popull e ndër rininë universitare e shkollë. Bashkëveprimi me shqiptarët merr hove të reja. Forcat që insistojnë për një federatë sa më pak centraliste etiketohen, ose emërtohen si separatiste. Kryetari i atëhershëm i shtetit jugosllav socialist, Josip Tito, kërcënohet so do ta fusë në veprim "fshisën e hekurt" për të mposhtur naacionalizmin, por insiston njëherit se Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 63 është pengesë për demokratizimin socialist të marrëdhënieve ndërnacionale. Serbia unitariste me aleatët bëjnë ç'mos që të ruajnë pozitën hegjemontiste nëse jo kudo në Jugosllavi, atëherë në Kosovë gjithsesi. Objekt fërkimesh tashti bëhet pozita e ardhshme e shqiptarëve në Kosovë, ose pozita e ardhshme e Kosovës, siç thuhej. Shqiptarët në të ashtuquajturën Maqedoni, republika më artificiale e federatës, mund të trajtoreshin edhe më tej si një pakicë kombëtare që do të kishte të drejtë të botonte abetare e libra leximi në gjuhën amtare, kopje të teksteve në sllavishte. Politikanët sllavë të kësaj republike artificiale shumë të suksesshme në eksperimentet e shtypjes së shqiptarëve, me anë të burgosjeve dhe dënimeve të gjata kohore të shqiptarëve, demonstرونin vendosmërinë e tyre se për shqiptarët e kësaj quasi republike nuk kishte se çka të diskutohej. Vrasja e Sefer Selimit për kërkesa shumë reale dhe burgosjet e persekutimet e gjera për kërkesa barazie, derisa në vise të tjera të Federatës po diskutohej lirisht për çështje madhore si parimi i të drejtës së popujve për vetëvendosje me të drejtë për shkëputje nga federata jugosllave, shkaktoi një irritim të shprehur ndër popullatën shqiptare dhe kuptohej si një insistim i qarqeve shoviniste sllavomaqedonase për t'i mbajtur

shqiptarët plotësisht të nënshtruar, si një objekt prone i tyre. Vrasja e S. Selimit nuk pushoi kurrë në ato vite për të qenë objekt diskutimesh brendashqiptare, duke i pasur të qarta shkaqet që i "frymëzuan" shovinistët sllavë për të ndërmarrë një akt të tillë krimi me motive politike. Shtypi në sllavishte i stimuluar nga organet e sigurimit të shtetit, nisi ahëre të shkruante për këtë vrasje duke i dhënë një përmbajtje ofenduese jo vetëm personalitetit të Sefer Selimin, por gjithë shqiptarëve. Ata "zbuluan" se ky krim pati si shkak prapambeturin shqiptare, të personifikuar tashti në personalitetin e S. Selimit. Ky gjoja, i pakënaqur ngase dhëndri "nuk e paskësh larë gjithë borxhin e blerjes së gruas së vet (motrës së Seferit) ia paskësh marrë gruan atij dhe në këtë mënyrë e paskësh ofenduar dhëndërrin (dorasin, vrasësin) keq dhe ja ku na paskëshin qenë shkaqet e kësaj vrasjeje. Kësi çorbash bajate insistohej t'i shiteshin popullatës shqiptare, kurse në realitet e përpinin me qejf sllavët, ndërsa te shqiptarët trazonin një neveri. Versioni i vërtetë i kësaj vrasjeje as që mund të përmendej botërisht në biseda private, e ku më të bëhej temë gazetash. Të sjellim provë për këtë pohim, dënimin me burg disamujorë të drejtorit të atëhershëm të shkollës fillore të Vërtokut, të ndjerit Sadbi, ngaqë kishte thënë me gjysmë goje diku "më mirë është që të mos diskutoni për këtë". Organet e ndjekjes ia kishin zënë për të madhe se pse nuk ua paskësh shpjeguar të pranishmëve se "shkaku i vrasjes na paskësh qenë grindja ndërmjet miqve të hasmëruar". PROTESTA Për t'ia bërë të ditur opinionit politik jugosllav dhe atij të gjerë (të vetëdijshëm se çështja do të përfundonte me ndërhyrjen e organeve të sigurimit shtetëror e me gjykim) një grup atdhetarësh militantë, nxënës shkollash të mesme, me një profesor, mësues e një teknik si iniciatorë, vendosin që në vigjilje të festës së një maji të vitit 1972, të shkruanin parulla me kërkesa politike dhe me përmbajtje proteste për vrasjen e Sefer Selimit pak vite më parë. Po në atë kohë që u burgosën protagonistët e shkrimit të këtyre parullave, Në Kroaci u shua për çastin lëvizja e quajtur "Pranvera kroate" ("Hrvatsko proljeće"). Politikanët më autoritativë u detyruan të largohen nga skena politike (jo pushkatime alla Enver Hoxha), kurse nga radha e aktivistëve të ri kroatë dhe nga shtresat popullore u burgosën me qindra vetë në gjithë Kroacinë. Gjykimi i tyre do të fillonte në vjeshtë të 72-it. Për të mos nxituar me dhënien e dënimeve drakonike, autoritetet gjyqësore të të ashtuquajturës Maqedoni, me siguri nga sugjerimi i krerëve politikë të kësaj republike, pritën që gjykimi i grupit trevetësh shqiptar të mbahej në vjeshtë, fill pas gjykimeve në Kroaci edhe pse ishte paraparë të mbahej më se një muaj më parë, me qëllim që lartësia e dënimeve të ishte përafërsisht në të njëjtin nivel kohor me ato të grupeve kroate, edhe pse bëhej fjalë për kualifikime formale penale të ndryshme; shumë më të rënda në rastin e grupeve kroate. Tito në mënyrë të zhdrejtë i trajton të arsyeshme kërkesat kombëtare të grupit të Gostivarit.- Para se të fillonte procesi gjyqësor në Shkup, kryetari i Jugosllavisë së atëhershme Josip Broz Tito vizitoi Tetovën dhe në bisedime me aktivin politik të këtij qyteti, kur mori e foli për temën e paevitueshme, për të cilën edhe kishte ardhur në këtë qytet - "marrëdhëniet ndërnacionale" në kuadër të ndryshimeve kushtetutare, kritikoi, si zakonisht, nacionalistët dhe nacionalizmin shqiptar dhe nacionalizmat të tjerë në përgjithësi në këtë republikë, por duke e drejtuar tehun e kritikës nga partia komuniste: "Nëse Lidhja e Komunistëve (kështu quhej zyrtarisht partia komuniste e Jugosllavisë), nuk tregohet e gatshme dhe nuk angazhohet në mënyrë parimore dhe konsekuente në zgjidhjen e problemeve ndërnacionale, atëherë u lë hapësirë politike nacionalistëve shqiptarë që të dalin si artikulluesë të kërkesave të tyre nacionale". Ky pohim i Titos, që ishte një sinjal se kërkesat "e nacionalistëve shqiptarë" ishin me vend, por të manifestuara në "mënyrë armiqësore". u prit me hidhërim nga ana e shovinistëve sllavomaqedonasë. Në procesin

gjqësor që u mbajtë katër ditë, në mesin e muajit tetor të vitit 1972, përmbaruesit, ata që shkruajtën parullat u vunë në rolin e dëshmitarëve (!) dhe idedhënësit u ulën në bankinën e të akuzuarve. Gjykimi ishte paraparë të mbahej pas dyerve të mbyllura për shkak të drojës se të akuzuarit do të kompromentonin me aq fakte logjike e materiale që kishin organet e sigurimit shtetëror, që ishin regjisorët e atentatit mbi Sefer Selimin. Pas disa orë telefonatash ndërmjet gjyqit dhe urdhërdhënësve të tij, nën presionin e turmës prej qindra vetë përpara një zyre të vogël ku ishte paraparë të mbahej gjykimi, autoritetet e gjykatës ndërruan mendje dhe morën direktiva që gjykimi të mbahej në një sallë jo fort të madhe, që nuk zinte më shumë se 50 - 60 vetë. Figura qendrore e gjykimit ishte i ndjeri, doktor Mefail Azizi - Xixi, në cilësi dëshmitari. Ai ishte një gjeni i mendjemprehtësisë humoristike. Spektatorët që kishin mbushur sallën (ndër ta mjaft vetë rrinin në këmbë) me seriozitetin më të madh ndiqnin gjykimin. Në çastin kur në skenë doli të depononte (dëshmonte) i ndjeri Mefail Azizi, atëherë student i mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, pas dy-tre dialogjesh me prokurorin, kur dëshmitari prezantoi në mënyrë humoristike përkatësinë politike përmes pohimit se është tifoz i skuadrës futbollistike Dinamo të Zagrebit (aludim në aleancën politike nacionale kroato-shqiptare) me lëvizjet e tij të lira gojore e trupore, bëri që i gjithë auditori të shpërthente në një qeshje të shfrenuar me shumë zë. Trupi gjykues dhe prokurori u ndien të ofenduar. E gjithë kjo përfundoi me nervozizmin e prokurorit-se edhe ti duheshte të ishte i ulur së bashku me të akuzuarit. Përgjigja e Xixit qe: Më vie keq, tashti është vonë, nuk kemi se ç' bëjmë. (Me supe të mbledhura e krahë të hapur anësh). Të akuzuarit u shpallën fajtorë dhe morën dënime me burg - 4 vjet, 2 dhe 1 vit e gjysmë. Dënimet do të ishin shumë më drakonike, por u dhanë në nivel me dënimet që u shqiptuan në Kroaci javë më parë.

EFEKTI

Këto protesta u komentuan me nënçmim nga komunistët e "mençur" shqiptarë, disa nga të cilët janë marrë në konsiderim tashti nga neokomunistët, me emër integristë, si kandidatë të mundshëm për poste asistentë ministrash ose edhe ministër. Gjaku e kërkon gjakun dhe mendja-mendjen, thotë populli. Fatmirësisht, ose fatkeqësisht, atëherë nuk kishte liri shkrimi e liri fjale për të shprehur ndonjë pikëpamje që binte ndesh me ato të pushtetarëve. Njeriu ishte i detyruar të shfrytëzonte parullat nëpër mure për të komunikuar idetë e veta. Kështu veprohet në të gjitha diktaturat. Kështu vepronin republikanët kundër pushtetit të diktatorit Franko, kështu vepronin forcat antihuntiste në Greqinë e viteve 60-të, kështu vepronin filozofit Sartr në Francë, jo se ia ndalonte kush që të shkruante, por ia donte qejfi të konfrontohej me rendin shtetëror të Francës në vitet e 60-ta. Mendjeshkurtrit dhe lojalistët e sundimit antishqiptar të atëhershëm në RM i quanin me përbuzje "kovaxhi" protagonistët e kësaj proteste. Protesta e 72-it e Gostivarit nuk pati as për së afërmi atë bujën e demonstratave të 68-ës në Tetovë, por për nga përmbajtja, kërkesat ishin më të gjera, më të përfshime, më problemore dhe më të kohës. Po të thellohet njeri më shumë, ato janë kërkesat avangarde që iu paraprinë tre dekada më parë kërkesave shqiptare në Ohër, më 2001. Formalisht, në letër, atëherë u arrit që shqiptarët në kushtetutën e 74-it të IRJ të Maqedonisë të trajtohen si subjekt shtetformues. Po ashtu, sipas asaj kushtetute, shqipja fitoi një status konkret formal. Është thjesht temë tjetër sepse u shpërfill plotësisht në jetën praktike. Statusi i saj formal, në krahasim me gjuhën e nënkuptueshme e të abstraksioneve politike të Ohrit, që duhet të nënkuptohet se mund të jetë gjuha shqipe, ishte më i lartë në mënyrë të padiskutueshme. Mjafton të thuhet se ajo u emërtua gjuhë shqipe, pjesë e

identiteti kombëtar të shqiptarëve në këtë republikë. Është i dhimbshëm akti i krekosjes së politikanëve gjoja të moderuar sot se djemtë shqiptarë na paskëshin derdhur gjak dhe ia paskëshin dhuruar jetën popullit e atdheut, që gjuha e tyre, gjuha e amanetit të fundit, gjuha e psherëtimës, e grahmës dhe e fjalës së fundit - oj, nënë, të shndërrohet në dokumentin e turpit kombëtar - Marrëveshja e Ohrit, në një gjuhë pa emër, gjuhë e koduar "e etnisë mbi 20 %" gjuha e turpit, gjuha e një etnie inekzistente, gjuha e abstraksionit politik, gjuha e popullit të nënçmuar. Ata që kishin sens politik, armiqtë po se po, miqtë e shqiptarëve në Kroaci e gjetkë, forcat e atëhershme antidogmatike në Jugosllavi që ishin në anën e shqiptarëve dhe të kërkesave të tyre për avancimin e pozitës së tyre politike i kuptuan drejt këto mesazhe nga parullat e Gostivarit dhe i trajtuan si platformë për bisedimet rreth ndryshimeve kushtetutare. Një nga protagonistët e këtyre protestave rrëfen se një person i sigurimit shtetëror (jo të hetuesisë) e vizitoi disa herë rresht në burgun e hetimeve të Shutkës në Shkup, duke insistuar të dinte se (në mos ky, i akuzuari shqiptar për parullat) me cilët politikanë e aktivistë politikë kroatë e shqiptarë të Kosovës kishte pasur kontakte. Gazeta Vjesnik e Zagrebit, që pas pranverës së 72-it kontrollohej nga shteti, fill pas përfundimit të procesit gjyqësor kundër grupit të Gostivarit, doli me një koment ku sulmonte bashkëpunimin ndërmjet nacionalistëve kroatë dhe nacionalistëve shqiptarë në Maqedoni. Sipas një dëshmie të një imigranti shqiptar në Gjermani, gazeta e atjeshme "Züdeutschen zeitung" një koment për gjykimet politike në Jugosllavi (për ato kundër grupeve kroate dhe grupit të shqiptarëve të Gostivarit) e paskësh përfunduar me pohimin se tani më nisen të mos jenë të sigurt as themelet jugorë të Federatës së Jugosllavisë. Efektet e protestave të Gostivarit nuk duhet kuptuar si efekte ultimate. Ato pasqyruan frymën dhe disponimin politik të popullatës shqiptare. Në qarqet politike kosovare u mirëpritën nga fakti i ndërhyrjes së shtetit sllavomaqedonas për çështje që trajtoheshin në fjalorin politik të atëhershëm si probleme objektive reale, ndërsa kur këto u bënë objekt i kërkesave politike shqiptare, ahëre shqiptarëve të ashtuquajturës Maqedoni ua hapnin dyert e burgut për t'i futur brenda. Një qëndrim i pastër unitarist e hegjemonist, që do t'iu shërbente forcave politike shqiptare të Kosovës dhe forcave të atëhershme demokratike antihegjemoniste dhe antiunitariste si argument në luftën e tyre politike. Me këtë rast duhet të theksojmë një fenomen antishqiptar, që në mënyrë indirekte u përfshi në këto protesta. Ishte një e keqe e evidente antishqiptare, e cila thuajse është harruar Nga fundi i viteve 60-të dhe fillimi i 70-tës nisi popullëzimi i planifikuar i qyteteve shqiptare të të ashtuquajturës Maqedoni me pjesëtarë të etnisë greke, të emigruar më parë si komunistë në shtetet e lindjes socialiste. Po këta grekë komunistë të cilëve Titoja nuk iu hapi kufirin më 1949, tashti 20 vjet më vonë i riatdhesoi në qytetet shqiptare, duke iu siguruar punë e banesa falas, me një kusht që të deklaroheshin se ishin sllavomaqedonasë. Qëllimi ishte shumë i qartë: Të çrregullohej në mënyrë artificiale struktura etnike në këto anë, ku shqiptarët përbënin elementin e shumicës absolute 80 deri 90 %. Kundërpërgjigjja shqiptare ishte "T'i kthejmë shqiptarët nga Turqia". Pas kësaj proteste mori fund edhe plani për popullzimin artificial të trevave shqiptare. Nuk besoj se kjo parullë dhe kërkesë nuk pati efekt pozitiv në ndërprerjen e popullzimit të trevave shqiptare. Përkundrazi nga kjo ngjarje politike, protestat e 72-it, është sajuar tashti një anekdotë në Gostivar: "Kur tridhjetë vjet më parë diskutonte njeri për kërkesat politike shqiptare, do të kishte punë me hetues, prokurorë, gjykatës, policë e roje burgjesh, kurse tashti bisedon me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Thelbi mbetet i pandryshuar, ndërsa pëson forma, në të mirë". Emrat e protagonistëve të kësaj proteste përmes parullave nuk përmenden në këtë artikull, me dëshirë që të mbeten anonimë ashtu

siç kanë qenë gjithë jetën pas daljes nga burgu. Ata këtë vepër nuk e bënë as për nam, as për gjoksrrahje, as për t'u ulur në radhët e para në ndonjë mbledhje, as për të vënë kravata (kollare) politike rreth qafës. E ndien si borxh ndaj popullit, ndaj gjakut të Sefer Selimit, ndaj gjakut që drodhën atdhetarët tanë të Ballit Kombëtar, të Legalitetit, edhe të Partisë Komuniste me bindje se luftuan për atdhe, jo për ideale komuniste. Veprën e vet e konsiderojnë thjesht një akt modest, një gur të vogël mbështetës në gurët e mëdhenj të Kështjellës së Atdhetarizmit. Njëherit ata në mënyrë të veçantë iu shprehin mirënjohjet dhe admirimin e sinqertë kombëtar të gjithë trimave shqiptarë që ia dhuruan jetën atdheut në betejat e Kosovës, e Preshevës, e Kumanovës e të Tetovës. I kujtojnë me përkulje e me respekt të thellë të gjithë ata që u sakrifkuan për çështjen kombëtare në të gjitha trevat e Arbërisë, në të gjitha kohërat!¹³

PËRFUNDIM

Demonstratat e vitit 1968 kishin detyruar udhëheqjen jugosllave të rishqyrtojë statusin juridik të Kosovës dhe me këtë rast u ndërmorën disa veprime konkrete. Në shkurt 1969 u miratua ligji kushtetues për Kosovën, i cili hapi rrugë, që ajo ta ketë Kushtetutën e vet.

Me anë të ligjeve emërtimi "Kosovë e Metohi" si krahinë e Serbisë, ndërron emrin në "Krahina Socialiste Autonome e Kosovës (KSAK); po atë vit gjuha shqipe me ligj u rregullua si gjuhë e dytë zyrtare, krahas gjuhës serbo-kroatë; u legalizua përdorimi i flamurit kombëtar; ndërsa në nëntor 1969 Kuvendi i Kosovës shpalli ligjin për themelimin e Universitetit të Kosovës, i cili do të jetësohet më 15 shkurt 1970.

Së këndejmi, pas debatëve maratonike për ndryshimet kushtetuese (1967-1971), Kuvendi federativ i Jugosllavisë më 21 shkurt 1974 miraton Kushtetutën e re të RSFJ-së, ndërsa një javë më vonë (28 shkurt) edhe Krahina Socialiste Autonome e Kosovës e miraton Kushtetutën e parë të saj, e cila Kosovën e definoi njëkohësisht, si: "pjesë integrale të Serbisë" dhe "element konstituiv të federatës jugosllave".

Megjithatë, kjo Kushtetutë nuk do të kënaqë asnjëherë vullnetin e popullit shqiptarë, prandaj dhe organizatat politike ilegale nuk do ta ndalin veprimtarinë e tyre atdhetare për asnjë moment, për ta realizuar synimin madhor-vetëvendosjen dhe bashkimin kombëtar.¹⁴

¹³ ...Jam një nga ata, të cilët nuk janë marrë me shkrime, dhe e kam të vështirë t'i nisem kësaj pune. Megjithatë vendosa të lë në letër diçka nga kujtimet e mia jetësore duke shpresuar se dikujt do ti interesojë ndonjë hollësi, apo detaj në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur gjatë jetës sime. Në disa nga këto ngjarje kam qenë pjesëmarrës aktiv, por do te përmendi edhe ndodhiku të tjerët kanë qenë aktor, kurse unë i kam ndihmuar ose penguar në këto aktivitete. Do të shkruaj edhe detaje ndoshta të parëndësishme për shumicën e njerëzve, por që munde të jenë interesante për më të afërmit, miqtë ose familjaret e mi. Mendoj se mund të paraqiten edhe kureshtar, të cilët do të dëshironin të hyn në disa detaje të jetës sime. Kërkoj ndjesë për mos përfshirjen e ngjarjeve dhe personave të caktuar, por kjo do të jetë pasojë e harresës sepse nuk kam mbajtur shënime të duhura në kohën kur ngjarjet kanë ndodh. Në periudhën rinore kam pas shkruar edhe ditar, por fatkeqësisht këto janë marrë nga policia, e cila disa here ka ber bastisje ne banesat ku kam jetua ne periudha te ndryshme kohore. Ekziston mundësia reale, që nga këto shënime dikush të ndjehet i prekur, por për këtë është dashur të mendohet me herët... Ky është material i shkëputur nga ditari në dorëshkrim të cilin e posedoj, pasi ma ka dhënë familja e Dr. Imer Imerit, të cilin do ta botoj në të ardhmen!

¹⁴ Ismet Jonuzi - Krosi Golgota shqiptare II dhe III 1952-1960 dhe 1960-1968, 40 VJETORI I DEMONSTRATAVE TË FLUMURIT, Tetovë 2008, fq. 306/